

REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” SENATI AKADEMIK

Nr 3008/1 prot.

Elbasan, më 29.12.2021

VENDIM

Nr 42 datë 29.12.2021

**“PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E SENATIT AKADEMIK NR. 17 DATË
22.07.2021 “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT
“DOKTORATË NË SHKENCAT MJEKËSORE TEKNIKE””**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 38, Statutit të UE-së, neni 9, Rregullores së Studimeve në UE-së, me propozim të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike,

VENDOSI:

I. Në Vendimin e Senatit Akademik Nr. 17 datë 22.07.2021 “Për miratimin e Rregullores së programit të studimit “Doktoratë në shkencat mjekësore teknike” bëhet një ndryshim, neni 18 i Rregullores riformulohet me përmbajtjen si më poshtë:

Neni 18

18.1 Punimi hartohet në gjuhën shqipe dhe një përmbledhje e tij (2000-4000 fjalë) hartohet në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Europian (*anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, italisht*), në format të shtypur dhe elektronik. Përpara dorëzimit punimi miratohet nga udhëheqësi shkencor.

18.2 Punimi lidhet në pesë kopje origjinale. Në kopertinë duhet të vendoset:

- Emri i Universitetit (në krye, në mes të kopertinës);
- Emri i Fakultetit (në krye, mes të kopertinës);
- Emri i Departamentit, ku është zhvilluar programi i doktoratës (në krye, në mes të kopertinës);
- Stema e Universitetit (në krye, në anën e majtë të kopertinës);
- Stema e Fakultetit (në krye, në anën e djathtë të kopertinës);
- Fjala DISERTACION (në mes të kopertinës);
- Emri i programit të doktoratës (në mes të kopertinës);
- Emri i kandidatit (në fund, në anën e majtë të kopertinës);
- Emri dhe grada e Udhëheqësit (në fund, në anën e djathtë të kopertinës);
- Qyteti dhe viti i mbrojtjes (në fund, në mes të kopertinës).

18.3 Punimi shkencor ose disertacioni duhet të përbëhet nga këto pjesë kryesore:

- Abstrakti
- Mirënjohja



UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”

SENATI AKADEMIK

- Tabela e përmbajtjes
- Studimi
 - Hyrja
 - Shqyrtimi i literaturës së fushës dhe të çështjes
 - Shqyrtimi i materialit të vjele dhe qëndrimi vetjak
 - Përfundime
 - Bibliografia
 - Shtojca

18.4 Punimi duhet të respektojë kërkesat e formatit. Nëse formati nuk prezantohet sipas formatit të kërkuar, ai nuk pranohet derisa të plotësohen të gjitha kërkesat e formatit.

2. Punimi shkencor ose disertacioni duhet të realizojë këto anë teknike:

- 2.1. Abstrakti. Çdo punim duhet të përmbajë një abstrakt. Abstrakti duhet të jetë një përmbledhje që paraqet pikat kryesore dhe përfundimet e punimit. Abstrakti duhet të vendoset para falënderimeve dhe tabelës së përmbajtjes.
- 2.2. Mirenjohja. Duhet paraqitur mirenjohja për të gjithë ata që kanë kontribuar në realizimin e punimit dhe financimin e tij.
- 2.3. Tabela e përmbajtjes. Në këtë seksion paraqitet tabela e përmbajtjes me elementet e strukturës së punimit, titujt përkatës dhe numrin e faqeve për secilin element.

3. Studimi. Studimi, përgjithësisht, duhet të ketë këtë format:

- 3.1. Hyrja. Seksioni i hyrjes duhet të prezantojë fushën e studimit, çështjen e marrë në studim, detyrën shkencore, të përmbledhë informacionin e rëndësishëm dhe strukturën e punimit.
- 3.2. Lista e shtojcave. Në këtë seksion paraqiten vetëm listat e tabelave, ilustrimeve, shtojcave të përdorura në punim. Ky seksion përfshihet nëse tema jep mundësi për përdorimin e tabelave, ilustrimeve, shtojcave.
- 3.3. Shqyrtimi i literaturës së fushës dhe të çështjes. Në këtë pjesë paraqiten kontributet e 3.4. Shqyrtimi i materialit të mbledhur dhe qëndrimi vetjak i doktorantit.
- 3.5. Përfundime. Ky seksion përmbledh gjetjet kryesore të studimit.
- 3.6 Propozime të tjera. Ky seksion nuk është i detyrueshëm dhe kërkohet vetëm nëse rezultatet justifikojnë kërkimin e mëtejshëm.
- 3.7 Bibliografia. Të gjitha punimet shkencore duhet të përdorin literaturën dhe për citatat të tregojnë burimin e tyre. Seksioni i bibliografisë duhet të vendoset në faqe më vete.
- 3.8 . Shtojcat. Ky seksion përmban ilustrime shesë, të dhëna e shifra origjinale që janë shumë të gjata për t'u përfshirë në tekst. Ato përfshihen në “Shtojca” në mënyrë që të mos e shpëpusin lexuesin nga diskutimet origjinale. Shtojcat mund të ndahen në seksione. Secila shtojcë ka titullin e vet dhe mund edhe të paraqitet veçmas në faqen e tabelës së përmbajtjes. Në këtë rubrikë përfshihen materiale të tilla plotësuese si: instrumente të ndryshme të kërkitimit të përdorura në studim, pyetësorë, intervista, harta, dokumente ligjore, historike, seri fotografish etj.

4. Të gjithë kapitujt, çështjet, rubrikat e studimit renditen me rend numerik.

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
SENATI AKADEMIK

18.5 Formati i Punimit shkencor ose disertacioni duhet të respektojë kërkesat në vijim. Nëse punimi nuk prezantohet sipas formati të kërkuar, ai nuk pranohet derisa të plotësohen të gjitha kërkesat e formatit.

1. Lidhja. Tri kopje të punimit shkencor duhet të lidhen. Njëra prej kopjeve duhet të jetë origjinalja. Në kopertinë duhet të vendoset emri i universitetit të Elbasanit, i Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, i programit, titulli i plotë i temës, emri i kandidatit, emri i udhëheqësit shkencor, viti i mbrojtjes.
2. Disertacioni shoqërohet me një përmbledhje rreth 10 faqe në gjuhën angleze. Përdoret madhësia 10-she e shkronjave. Ky element duhet t’u mundësojë lexuesve të kuptojnë se si është trajtuar çështja e marrë në studim.
1. Fushën dhe fjalët kyçe. Studenti në bashkëpunim me udhëheqësin shkencor përcakton fushën dhe zgjedh fjalët kyçe në funksion të përshtatshmërisë së tyre me terminologjinë e përdorur në disiplinën përkatëse. Ato ndihmojnë identifikimin e tezës midis katalogëve kolektive në biblioteka.
2. Gjatësia e punimit. Pjesa e studimit shkencor për diplomën “Doktor i shkencave albanologjike” përcaktohet nga KP. Si rregull duhet të ketë jo më pak se 120 dhe jo më shumë se 160 faqe kompjuterike. Referencat, shënimet në fund të faqes, shtojcat, tabelat, diagramet nuk përfshihen në këtë përlllogaritje.
3. Vendi që zënë elementet e punimit:
 - Hyrja 10 %
 - Shqyrtimi i literaturës së fushës dhe të çështjes 30%
 - Shqyrtimi i materialit të mbledhur dhe qëndrimi vetjak 45%
 - Përfundime - 10%
 - Bibliografia – 5%
4. Për të llogaritur kufirin e fjalëve dhe të faqeve rekomandohet metoda e mëposhtme e llogaritjes:
 - maksimumi 2310 karaktere për faqe për punimin e mikrotezës
 - numri i karaktereve llogaritet duke përfshirë hapësirën, pikësimin në një radhë dhe shumëzohet me numrin e radhëve
 - në një radhë do të ketë 70 karaktere me një maksimum prej 33 radhësh.
5. Duhet përdorur letër e cilësisë së lartë, e bardhë, format A4.
6. Materiali duhet të shtypet vetëm nga njëra anë e letres. Të gjitha kopjet e studimit duhet të jenë të shtypura me kompjuter, të printuara qartë dhe të jenë të lexueshme lehtësisht. Dorëshkrimet nuk pranohen.
7. Teksti duhet të shtypet me hapësirë një e gjysmë ndërmjet radhëve. Hapësira njëshe do të përdoret për përgatitjen e tabelave të gjata, të ekstrakteve, të shënimeve, të shpjegimeve të gjata dhe të listës së bibliografisë. Vetëm një lloj shkrimi duhet përdorur. Lloji i shkrimit duhet të jetë Times New Roman. Masa e shkronjës duhet të jetë 12-she.
8. Margjimat për të gjithë tekstin do të jenë
 - Margjina e sipërme: 1 “
 - Margjina e poshtme: 1 “
 - Margjina e majtë: 1.25 “



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” SENATI AKADEMIK

- Margjina e djathtë: 1.25 “

9. Numrat e faqeve. Të gjitha numrat e faqeve duhet të vendosen poshtë dhe në mes të faqes.

- Hyrja duhet të ketë numra romakë.
- Pjesa e studimit duhet të ketë numra arabë.
- Faget e bibliografisë, shtojcave duhet të numërohen me numra arabë në vijim të numrave të tekstit.

10. Studentët këshillohen të përdorin referenca të botimeve të ndryshme të fushës, të raporteve ose të disertacioneve të kandidatëve të suksesshëm të cilat mund të gjenden në biblioteka. Madhësia e shkronjave të shënimeve është më e vogël se ajo e tekstit. Shënimet në fund të faqes si dhe të gjitha llojet e tjera të shënimeve duhet të shkruhen me shkronja me madhësi 10-she.

- Administrimi i të dhënave të çdo doktoranti, të realizohet sipas shtojcës nr. 2 të rregullores “Mbi vlerësimin e veprimtarisë vjetore kërkimore-shkencore të doktorantit”, me përmbajtje sipas tekstit që i bashkëngjitet këtij vendimi.


II. Ngarkohet Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike me zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Skender TOPI





UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
SENATI AKADEMIK

REPUBLIKA E SHQIPËRISE

Shtojca nr. 2

Mbi vlerësimin e veprimtarisë vjetore kërkimore-shkencore të doktorantit.

- Plani vjetor 3 vjeçar

Viti	Veprimtaria	Realizimi		
1	Formimi teorik	Realizuar plotësisht	Realizuar pjesërisht	Mos realizuar
	Kërkimor shkencor			
	Pjesëmarrje në konferenca	Realizuar plotësisht	Realizuar pjesërisht	Mos realizuar
	Aktivitete specifike mbi metodologjinë e kërkimit shkencor	Realizuar plotësisht	Realizuar pjesërisht	Mos realizuar
	Asistencë në mësimdhënie lidhur me fushën e kërkimit	Realizuar plotësisht	Realizuar pjesërisht	Mos realizuar
	Shqyrtimi i literaturës	Realizuar plotësisht	Realizuar pjesërisht	Mos realizuar
	Hartimi i planit të projektit të kërkimit ku të përfshihen të paktën qëllimi, metodat e kërkimit, burimet e nevojshme, dhe rezultate të pritshme	Realizuar plotësisht	Realizuar pjesërisht	Mos realizuar

Viti	Veprimtaria	Realizimi		
2	Përmirësim/ndryshim i planit të projektit shkencor	Realizuar plotësisht	Realizuar pjesërisht	Mos realizuar



UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
SENATI AKADEMIK

ose fillimi i tij nëse është miratuar nga komisioni përkatës			
Aktivitet klinik në spital ose institucione të tjera shëndetësore sipas fokusit të kërimit	Realizuar plotësisht	Realizuar pjesërisht	Mos realizuar
Publikime shkencore mbi gjetjet nga literatura	Realizuar plotësisht	Realizuar pjesërisht	Mos realizuar
Zbatimi i projektit	Realizuar plotësisht	Realizuar pjesërisht	Mos realizuar
Shqyrtim i literatures dhe Analiza statistikore	Realizuar plotësisht	Realizuar pjesërisht	Mos realizuar

Viti	V e printaria	Realizimi		
3	Shkrimi i disertacionit	Realizuar plotësisht	Realizuar pjesërisht	Mos realizuar
	Pjesëmarrje në aktivitete shkencore (konferenca seminare) me interes në fushën kërkimore	Realizuar plotësisht	Realizuar pjesërisht	Mos realizuar
	Prezantimi i punimeve në departament.	Realizuar plotësisht	Realizuar pjesërisht	Mos realizuar
	Përfundimi i disertacionit dhe detyrimeve të tjera si doktorant	Realizuar plotësisht	Realizuar pjesërisht	Mos realizuar
	Dorëzimi i disertacionit te komisioni, mbrojtja e tezës	Realizuar plotësisht	Realizuar pjesërisht	Mos realizuar



UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
SENATI AKADEMIK

• **Plani vjetor 5 vjeçar**

Viti	Veprimtaria	Realizimi		
1	Formimi teorik	Realizuar plotësisht	Realizuar pjesërisht	Mos realizuar
	Kërkimor shkencor			
	Pjesëmarrje në konferenca	Realizuar plotësisht	Realizuar pjesërisht	Mos realizuar
	Aktivitetet specifike mbi metodologjinë e kërkimit shkencor	Realizuar plotësisht	Realizuar pjesërisht	Mos realizuar
	Asistencë në mësimdhënie lidhur me fushën e kërkimit	Realizuar plotësisht	Realizuar pjesërisht	Mos realizuar

Viti	Veprimtaria	Realizimi		
2	Shqyrtimi i literaturës	Realizuar plotësisht	Realizuar pjesërisht	Mos realizuar
	Hartimi i planit të projektit të kërkimit ku të përfshihen të paktën qëllimi, metodat e kërkimit, burimet e nevojshme, dhe rezultate të pritshme	Realizuar plotësisht	Realizuar pjesërisht	Mos realizuar

Viti	Veprimtaria	Realizimi		
3	Përmirësim/ndryshim i planit të projektit shkencor ose fillimi i tij nëse është	Realizuar plotësisht	Realizuar pjesërisht	Mos realizuar



UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
SENATI AKADEMIK

	miratuar nga komisioni perkatës			
	Aktivitet klinik në spital ose institucione të tjera shëndetësore sipas fokusit te kërkimit	Realizuar plotësisht	Realizuar pjesërisht	Mos realizuar
	Shqyrtim i literatures			
	Publikime shkencore mbi gjetjet nga literatura	Realizuar plotësisht	Realizuar pjesërisht	Mos realizuar
	Analiza statistikore Shqyrtim i literatures dhe Analiza statistikore	Realizuar plotësisht	Realizuar pjesërisht	Mos realizuar

Viti	Veprimtaria	Realizimi		
4	Zbatimi i projektit	Realizuar plotësisht	Realizuar pjesërisht	Mos realizuar
	Aktivitet klinik në spital ose institucione të tjera shëndetësore sipas fokusit te kërkimit	Realizuar plotësisht	Realizuar pjesërisht	Mos realizuar
	Shqyrtim i literatures			
	Shqyrtimi i literaturës	Realizuar plotësisht	Realizuar pjesërisht	Mos realizuar
	Shkrimi i disertacionit	Realizuar plotësisht	Realizuar pjesërisht	Mos realizuar

•

Viti	Veprimtaria	Realizimi		
5	Shkrimi i disertacionit	Realizuar plotësisht	Realizuar pjesërisht	Mos realizuar
	Pjesëmarje në aktivitete	Realizuar plotësisht	Realizuar pjesërisht	Mos realizuar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
SENATI AKADEMIK

shkencore (konferenca seminare) me interes në fushën kërkimore			
Prezantimi i punimeve në departament.	Realizuar plotësisht	Realizuar pjesërisht	Mos realizuar
Përfundimi i disertacionit dhe detyrimeve të tjera si doktorant	Realizuar plotësisht	Realizuar pjesërisht	Mos realizuar
Dorëzimi i disertacionit te komisioni, mbrojtja e tezës	Realizuar plotësisht	Realizuar pjesërisht	Mos realizuar